

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



DATE 09/07/2024
NR REP 5081



VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 09/07/2024, para meje Noteres MAJLINDA DEMOLLARI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NËSIA ADMINISTRATIVE NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA NR .10, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Nesrin Ozdemir, shtetase Turke, lindur në Istanbul dhe banues në Turqi, lindur më 30/10/1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Tjetër nr. U29994839.

E cila me kerkoi qe te bej vertimin e kopjes me origjinalin te dokumentit:

- Statut/Akt Themelimi

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin original.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIP: K41606060A
Tel: 0682061860

**STATUT/AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK”**

Ne baze te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME
FORMIMI I SHOQERISE
NENI 1**

1 . Shoqeria tregtare “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**” shpk me seli ne adresen Tirane Kashar ,Yrshek Godina nr 25, H24, Tirane, formohet nga ortaku themelues:

Z.Nesrin Özdemir, i datelindjes 30.10.1983, lindur ne Istanbul, banues ne Bahcelievler /Turqi, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer identifikimi personal U29994839, referuar ne vazhdim si Ortaku i Vetem.

E cila me vullnetin e saj te lire dhe te plote dhe ne perputhje me ligjin “PER SHOQERITE TREGTARE”, REGJISTRIN TREGTAR si dhe AKTIN E THEMELIMIT ka vendosur te destinoje ne kete supermarrje kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

2. Shoqeria e ushtron veprimtarine ne baze te ekonomise se tregut te lire.
3. Shoqeria eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar duke u pajisur me lejen e ushtrimit te te profesionit nga zyra e qendres kombetare te regjistrimit (QKB)te rajonit perkates.
4. Shoqeria tregtare “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**” shpk fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj prane zyres se qendres kombetre te regjistrimit(QKR).

**FORMA, EMERTIMI
NENI 2**

1. Shoqeria Tregtare eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.
2. Emertimi i Shoqerise eshte “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**” shpk.
3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te ruhet i njejt emertim, me kusht qe personi juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.
4. Shoqeria zoteron dhe perdor marken, simbolin dhe vulen e saj me emrin “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**” ose “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**” ose “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**”. Keto nuk mund te zoterohen apo perdoren nga pale te tjera si vendas apo te huaj pa miratimin me shkrim te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie.

SELIA

NENI 3

Selia e shoqerise “**NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK**” shpk ndodhet në Tiranë, Tirane Kashar ,Yrshek Godina nr 25, H24 Tirane. Albania. Shoqeria mund te krijoje filiale, dege e perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ashtu dhe jashte territorit te saj sipas nevojave. Selia mund te ndryshohet/transferohet ne cdo vend tjeter me vendim te Asamblese se Ortakut/eve, i cili ratifikohet nga mbledhja e afert e asamblese se zakonshme. Keto vendime depozitohen ne Regjistrin Tregtar.

NENI 4

KOHEZGJATJA

1. Shoqeria tregtare "NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK" shpk do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet duke perfshire edhe edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

OBJEKTI

NENI 5

Shoqeria "NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK" sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- Kryerjen dhe zhvillimin e te gjitha veprimtarive dhe akteve qe lejon legjislacioni edhe aktet nenligjore ne fuqi, ne fusha te ndryshme te keshillimit psikologjik , dhe hapje te qendrave arsimore dhe keshilluese, etj., si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne territorin Nderkombetar.
- Gjithashtu, ushtrimi i cdo lloj operacioni tjeter legal qe mund te jete e nevojshme per Shoqerine.

NENI 6

Shoqeria Tregtare "NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK" sh.p.k., nuk perqigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj. Ky kapital depozitohet sipas ligjit. Ne librin e llogarise te Shoqerise krijohet fondi themeltar ku shenohet kapitali i ortakeve.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali themeltar eshte 100.000(njeqindmije) Leke, i ndare ky ne 1 kuota, nga ku 100% e kapitalit i perket Z.Nesrin Özdemir.

NENI 8

Shoqeria ka te drejte te krijoje fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik dhe tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te veçante percaktohen nga ortaketet sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi cdo operacion finanziar i saj do te pasqyrohet ne kontabiliteten e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria tregtare "NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK" sh.p.k., eshte pronare e pasurise se saj te cilin e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te marre, te perdore, te bleje apo shese dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike, apo kontabiliteti dhe juridike paguhen vetem nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohej ne monedhe shqiptare.

2. Aktiviteti finanziar i shoqerise do te mbyllte me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vtitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vtitit finanziar, raportet e vecanta te ortakeve te hartuara nga ortaketet dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me vendim te ortakeve.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato Jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjesave te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfittues do te behet pasi ata te pranojne permajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjesa te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me vendimin e ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

NENI 16

ORTAKERIA

Ortaket e shoqerise tregtare "NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK" sh.p.k., gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper te gjitha detyrimet qe pasqyrohen ne legilsacion e republikes se shqiperise, ne aktin e themelimit dhe ne satutin e shoqerise.

NENI 17

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKOVE.

1. Te marrin pjese ne mbledhjet e asamblese se ortakeve duke ushtruar te drejten e votes.
2. Te paraqesin pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit.
3. Te informohen mbi perqatitjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel.
4. Te perfitojne nga fitimi i shoqerise.
5. Te kerkojne prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara.



NENI 18

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

1. Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i zgjedhur nga Ortaku i Shqoerise. Si Administrator i shoqerise do te zgjidhet **Nesrin Özdemir**, me nje afat 5 vjecar, e cila perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet. Administratori do te kryeje te gjitha veprimet zyrtare te shoqerise.
2. Shoqeria, ne te ardhmen mund te administrohet edhe nga nje Administrator tjeter, i cili emerohet me Vendim te Ortakut/eve.
3. Administratori, mund t'i delegoje kompetencat e tij(pjeserisht ose te gjitha) me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

3

4. Vendimet e ortakeve, evidencohen ne nje rregister te vecante.

NENI 19

ASAMBLEJA

Asambleja e Pergjithshme ka te drejte:

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne statut.
2. Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise.
3. Te vendose per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
4. Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise.
5. Te shpalle prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqerise.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

NENI 20

TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka keto te drejta.

1. Te mbikeqyre dhe te kontrolloj gjithe veprimtarine e shoqerise.
2. Te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet, ne administraten publike dhe oraganet gjyqesore.
3. Te emeroje personelin e domosdoshem.
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise.
5. Te therrase asamblene dhe te vendose rendin e dites.
6. Te hartoje planet e llogarive ekonomike dhe te paraqese ato per miratim asamblese se ortakeve.

NENI 21

Administratori eshte perjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te satutit apo per faj te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 22

1. Shoqeria "**NESRIN PSIKOLOJIK DANismanlik**" sh.p.k., mund te emeroje ne vazhdimesi nje ekspert kontabel per nje afat kohor te percaktuar me te drejte rizgjedhje.
2. Emerimi kryhet nga ortaket.
3. Per kompetencat, shkarkimin dhe shperblimin etij zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 23

MARREDHENIET E PUNESIMIT

1. Te gjithe personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet ne baze te kontrates individuale te punes ose kolektive, ne te cilin do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin vendas ne kete fushe.
2. Marrja ne pune behet me ane te regjistrimit nga ana e punedhenesit ne librin e punes se shoqerise.
3. Largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori. Largimi nga puna lidhet me mbarimin e kontrtaes se punes, per shkak te shkeljes disciplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
4. Mos marreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise do te zgjidhen me mirekuptim, ose kur ky i fundit nuk eshte i mundur palet do ti drejtohen gjykates kompetente perkatese.

NENI 24

BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQERISE

1. Shoqeria tregtare "**NESRIN PSIKOLOJIK DANismanlik**" sh.p.k., me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne dhe qe

ushtron te njejtin aktivitet.

2. Shoqeria tregtare "NESRIN PSIKOLOJIK DANISMANLIK" sh.p.k., me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ezistuese ose shoqerive te reja.

NENI 25

PRISHJA DHE LIKUDIMI I SHOQERISE.

1. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfare do lloj shkaku, si ne rast falimentimi, privimi te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.

2. Shoqeria hyn ne fazen e e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj.

Per kete, ortaket emerojne nje ose me shume likujdator.

3. Shoqeria prishet ne keto raste:

- Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilin eshte krijuar.
- me vullnetin e ortakeve.
- me vendim te gjykates.
- kur mbaron afati i veprimitarise se shoqerise.

NENI 26

DISPOZITA TE FUNDIT

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te aplikohet ligji "PER SHOQERITE TREGTARE" si dhe legislacioni ne fuqi.

NENI 27

Ky statut hyn ne fuqi diten e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtarne qendren kombetare te regjistrimit(QKB).

NENI 28


Ky statut perpilohet ne 3 kopje origjinale me te njejen vlere ligjore perktheu **Taulant Anamali i njohur dhe pranuar nga ortaku.**

Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Nesrin Özdemir




Taulant Anamali



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



DATE 08/07/2024
NR REP 5031

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 08.07.2024 (dymije e njezete e kater), vertetoj nenshkrimin e ortakut te vetem themelues te shoqerise "Nesrin Psikologjik Danismanlik" me adresë Kashar, Yrshek, godina nr. 25, H24, me ortak **Nesrin Ozdemir**, shtetase turke, lindur në Istanbul, Turqi dhe banues në Turqi lindur më 30/10/1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte me nr. U29994839. E cila me ka deklaruar se Aktet Jane firmosur prej saj jashtë kesaj zyre noterie dhe Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE
Majlinda S. Demollari
NIP: R416950204
Tel: 0532051860